c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

---

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i mallrave</b>	<b>Norma e fitimit</b>

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	



**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i mallit</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi per njësi</b>	<b>Çmimi total për artikull (3 x 4X)</b>	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					

---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: **Blerje pajisje laboratorike për Institutin e Ndërtimit**

#### LISTA E PAJISJEVE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

##### **1. PRESA AUTOMATIKE MULTIFUNKSIONALE PER BETONIN**

*Pajisja te kete strukture testimi per kube, cilindra dhe blloqe betoni.*

*Pajisja duhet te jete konform EN 12390-4, EN 772-1, BS 1881:115, 6073, DIN 51220, NF P18-411, ASTM C39, C140, C1314 ose ekuivalent.*

*Duhet te kete kapacitet te pakten 3000 kN*

*Struktura e pajisjes te jete solide me 4 kollona*

*Siperfaqet e pllakave shtypese per provat mbi blloqe duhet te jene afersisht 310 x 510 x 55 mm me tolerance +/- 10mm dhe me nje levizje minimalisht 50 mm.*

*Siperfaqet e pllakave shtypese per provat mbi kuba dhe cilindra te jene me diameter me te madh se Ø280.*

*Pllakat e sipërme dhe te poshtme shtypese te preses duhet te jene te pajisura me certifikate te gjurmueshme te fortesise se siperfaqes se testimit. Hapesira e drites vertikale te jete nga 330-360 mm*

*Hapesira e drites horizontale midis kollonave te jete nga 340-380 mm*

*Pajisja duhet te jete e pajisur me pllakat distancuese te cilat sherbejne per kryerjen e testimeve per te gjiha mostrat si meposhte:*

- *kuba 10, 15 dhe 20 cm,*
- *cilindra (100x200)/(110x220)mm, 150x300mm, 160x320 mm - dhe blloqe deri ne 500x300 cm.*

*Klasin 1 nga 1% e ngarkeses maksimale.*

*Pajisja duhet te jete e pajisur me nje kit per proven e shperthimit dhe te jete e pajisur me nje dere polikarbonat ose ekuivalent.*

*Pajisa duhet te kete nje Kit/Mekanizem per te ngritur pjesen e poshtme te pllakave per lehtesimin e pozicionimit te distancatoreve. Pajisa duhet te jete e pajisur me nje Mekanizem rreshqites për heqjen e lehtë të pllakës se sipërme.*

*Pajisa duhet te jete e pajisur me nje aksesore te vecante per testimin e rezistences ne terheqje indirekte per mostrat cilindrike konform standarteve EN 12390-6, ASTM C496 ose ekuivalent. Ky aksesore te testoj cilindra me Ø150mm x 300mm, Ø 160mm x 320mm.*

---

*Pajisa duhet te jete e pajisur me nje aksesor te vecante per testimin e rezistences ne terheqje indirekte per mostrat ne kubat me permasa 100mm dhe 150mm dhe pllakat e betonit konform standarteve EN 1338, 12390-6 ose ekuivalent.*

*Ky aksesor te kete te perfshire shirita paketimi per mostren me permasa te pakten 4 x 15 x 345 mm sipas standardeve EN 1338 dhe EN 12390-6.*

*Te kete indikator per kontrollin e levizjes se pistonit gjatë provës.*

*Njesia e kontrollit te jete plotesisht e automatizuar dhe me ekran me prekje me ngjyra jo me te vogel se 5.5”*

*Te kete mundesi te nxjerrjes se arkivave me USB dhe te mundesoje skanimin me barkod te mostrave, etj.*

*Te jete me rezolucion te larte dhe te pakten 6-8 kanale analoge te pershtatshem per sensor ngarkese ose zhvendosje.*

*Te jete e pajisur me program kompjuterik qe te beje te mundur perdorimin ne distance te sistemit, marrjen e te dhenave, procesimin dhe dokumentimin. Pajisja te kete lidhjen LAN.*

*Pajisja duhet te përfshije sistem te avancuar me te dhenat e meposhtme:*

*për përcaktimin e raportit të Modulit Elastik dhe Poisson e pajisur me nje printer te brendshem dhe mundesi lidhje me printer te jashtem.*

*Te kryeje ciklet e ngarkimit dhe shkarkimit me shpejtesi te kontrolluar.*

*Te kete elektrovalvul ngarkimi dhe shkarkimi per kryerjen e testimit me ane te ekranit ose kompjuterit dhe ndalim automatik ne rast avarie.*

*Te jete e pajisur me njësi kontrollit per të menaxhuar deri në 8 kanale me rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni.*

*Programi i menaxhimit te jete i zhvilluar ne platformen Windows. Te përmbaje profilet e Standardeve kryesore të përdorura, dhe te kete mundesi per përdoruesin të modifikojë sipas dëshirës dhe të personalizojë profilin e testimit që do të kryhet në mënyrë krejtësisht automatike nga pajisja e testimit.*

*Programi te lejoj përcaktimin e modulit fillestar dhe të stabilizuar siç kërkohet nga standardi EN 12390-13.*

*Programi te mundesoj printimin e një certificate testimi me rezultatet e të gjitha të dhënave në lidhje me testin dhe mostren dhe grafikon e provës.*

*Programi te mundesoj shfaqjen grafike/numerike në kohë reale te të gjitha të dhënave të provës*

*(ngarkesa, sforcimi, zhvendosja, thithja e energjisë, devijimi, duktiliteti etj.)*

*Te mundesoje qe me nje njesi kontrolli te lidhen te pakten tre struktura prove te ndryshme.*

---

*Programi te menaxhoje kontrollin automatik te pajisjes së testimit për të matur: ngarkesa ose forca, zhvendosje dhe tensionet.*

*Te jete e pajisur me nje motorr me fuqi mbi 700W*

*Te kryeje testimin ne shtypje, terheqjen indirekte, modulet elastike etj ne menyre automatike me shpejtesi testimi te kontrolluar nga nje sistem PID.*

*Te beje shfaqjen ne kohe reale dhe e njekohshme te ngarkeses, stresit, raportit aktual te ngarkeses, grafikun ngarkese-kohe, grafikun stres-lodhje, zhvendosjen dhe zgjatimin ne %, grafikun stress/zgjatjen ne %.*

*Ruajtja në EN ose ASTM ose ekuivalent në rezultatet e provave të ngjeshjes të betonit.*

*Te kryeje automatikisht testet per modulin e elasticitetit ne perputhje me standardet kryesore nderkombetare me llogaritje automatike te rezultateve te testimit.*

*Burimi i Ushqimit: 220-240V, 50/60Hz.*

## **2. KABINET VERTIKAL PER LABORATORIN E ÇIMENTOS (DOLLAP PËR MOSTRAT E ÇIMENTOS)**

*Kabinet vertikal i pershtashem per ruajtjen e mostrave te cimentos.*

*Te jete ndertuar me strukture te forte polikarbonat/polipropileni, rezistent ndaj kimikateve.*

*Lageshtia te ruhet konstante te pakten 95 % deri ne ngopje nepermjet nje nebulizatori uji.*

*Te jete i lidhur me njesi frigoriferike për kontroll më të mirë të temperatures dhe me krompesor ajri.*

*Kapaciteti te pakten te pakten 500 litra, me dimesione te brendshme jo me pak se 1000 X 400 X*

*1200 mm*

*Kabineti te perfshij njesi frigoriferike me ftohje te ujit nga temperatura e ambientit ne te 8 - 10 °C. Te jete e prodhuar me material inox, i kompletuar me motorpompë, sensor dixhital të termostatit. I kompletuar me tuba dhe aksesorë.*

*Kabineti te perfshije kompresorin e ajrit me kapacitet rezervuari jo me pak se 200-liter.*

*Te kete te pakten 4 raftet prej celiku inoks per vendosjen e prizmave te cimentos.*

*Te jete konform standarteve EN 196-1, ASTM C511, ASTM C109, ISO 679, EN 196-8 ose ekuivalente.*

## **3. PRESË PËR PROVAT NË TËRHEQJE TË CELIKUT DHE PËRCAKTIMIN E REZISTENCËS NË PËRKULJE TË CELIKUT**

*Pajisja duhet te jete konform stadardeve EN ISO 6892-1, EN 7500-1 | EN 10002, EN 10080, EN 50081-1, EN 15630-1, EN 15630-3 | ASTM A370, ASTM E8 UNI 7676 ose ekuivalent.*

*Pajisja te kete force  $\geq 1000\text{kN}$  me levizje pistonit prej te pakten 250 mm. Te jete me sistem hidraulik qe rregullon shkallen e ngarkeses.*

*Te kete strukture me katër kolona dhe të ketë ngurtësi të lartë strukturore*

---

*Te kete qelizë ngarkese me precizion të lartë, Klasa 1 sipas standardit ISO 376, ISO 7500-1 ne diapazon te forces 10 deri ne 1000kN.*

*Te kete nofulla hidraulike, për shtrëngim të mostrave.*

*Te mundësoje vendosjen e aksesorëve për provat e tërheqjes në bulonat e dadove, kabujt e celiku, etj.*

*Struktura e poshtëme te jete e lëvizshme me panel butonash për funksionim të lehtë të makinës dhe pozicionim të mostrave.*

*Pajisja te mundesoje cikle plotësisht automatike te provës me feedback dixhitale.*

*Pajisja te kete Njësi te kontrollit elektronik me ekran me ngjyra me prekje, që te mund te funksionojë si një PC standard i bazuar në sistemin operativ Windows ose alternativ. Pajisja te mund të lidhet me një PC për një ekzekutim të testit në distancë. Te kete porte LAN per Lidhje direkte me Intranet dhe internet. Te kete mundesi te marrë një analizë të menjëhershme diagnostikuese nga prodhuesi. Te jete e pajisur me portat dixhitale USB, lexues karte SD, etj.*

*Te jete me rezolucion te larte dhe te pakten 6-8 kanale analoge te pershtatshem per sensor ngarkese ose zhvendosje.*

*Te jete e pajisur me njësi kontrollit per të menaxhuar deri në 8 kanale me rezolucion të lartë për kontrollin e qelizave të ngarkesës ose transduktorëve me urë matëse tensioni.*

*Programi i menaxhimit te jete i zhvilluar ne platformen Windows. Te përmbaje profilet e Standardeve kryesore të përdorura, dhe te kete mundesi per përdoruesin të modifikojë sipas dëshirës dhe të personalizojë profilin e testimit që do të kryhet në mënyrë krejtësisht automatike nga pajisja e testimit.*

*Programi te lejoj përcaktimin e modulit fillestar dhe të stabilizuar siç kërkohet nga standardi EN 12390-13.*

*Programi te mundesoj printimin e një certifikate testimi me rezultatet e të gjitha të dhënave në lidhje me testin dhe mostren dhe grafikun e provës.*

*Softueri duhet te kryeje përpunimin e rezultateve të provës së tensionit: ReL, ReH ose Rp e llogaritur në tre përqindje të ndryshme të zgjatjes të zgjedhura nga përdoruesi, Agt, A, Ag, Z, At, Ae, Rt, moduli elastik E, etj, në përputhje me EN ISO 6892- 1 dhe EN 15630-1 ose ekuivalent për armaturat prej çeliku.*

*Pajisja te kete fleksibilitet te larte dhe minimalisht te mbuloje aplikimet e meposhtme:*

- *Proven e tërheqjes*

*Provat e tërheqjes në shiritat e çelikut dhe rrethoret me diameter  $\geq 60$  mm.*

- *Prova e tërheqjes në llamarinat e çelikut me dimensione  $\geq 40$  mm*

- *Provat e tërheqjes në fijet e telit dhe rrjeten e çelikut te elektro-salduar*



- 
- *Provat tërthore në mostrat e çelikut*
  - *Provat e përkuljes dhe ri-përkuljes në mostrat e çelikut - Provat e tërheqjes së litarit me tel etj.*

*Pajisja të këtyre të pakten ekstensometra elektronik koaksial me precizion të lartë që përdoren deri në keputje të mostrave sipas standardeve ASTM A370 dhe EN ISO 15630-1 ose ekuivalent për mostrat rrethore me diapazon:*

- *Ku të përfshihen minimalisht diametrat nga Ø6 deri në Ø45 dhe me shume.*
- *Levizja e transduktorit për shufrat me diametër të vogël të jetë  $\geq 25\text{mm}$*
- *Levizja e transduktorit për shufrat me diametër të madh të jetë  $\geq 50\text{mm}$*

*Pajisja duhet të ketë ekstensiometer elektronik koaksial për mostrat petashuqe me levizje të transduktorit  $\geq 50\text{ mm}$ .*

*Pajisja duhet të ketë minimalisht këto elemente sigurie:*

- *Valvul presioni që ndalon automatikisht makinerinë kur presioni i vajit i afrohet kufirit*
- *Çelsat e kufirit maksimal të udhëtimit për të kontrolluar pozicionin e kokës së lëvizshme*
- *Softueri ndalon makinerinë kur arrihet ngarkesa maksimale*
- *Butoni i ndalimit të urgjencës*

*Pajisja të kryejë proven e përkuljes dhe ri-përkuljes sipas standardeve UNI EN ISO 15630-1, UNI EN ISO 15630-3, ASTM A615, ASTM E290, UNI EN ISO 7438, UNI EN ISO 8491 ose ekuivalent, ku të përfshihen minimalisht diametrat e mostrave Ø8 deri në Ø40 dhe me shume. Pajisja e provës duhet të jetë e pajisur me mandrinot përkatëse për realizimin e provës së përkuljes dhe të ripërkuljes minimalisht për diametrat e mostrave Ø8 deri në Ø40.*

*Pajisja të jetë e pajisur me ekstensiometer elektronik sipas standartit UNI 7676 ose ekuivalente për litar (kavo) çeliku që aplikohet drejtpërdrejt në kampion për matjen e deformimit/zgjatjes së litarit deri në keputje. Transduktori elektronik të ketë një udhëtim  $\geq 50\text{ mm}$  dhe me një gjatësi të matesit maksimumi 600 mm.*

*Pajisja mos jetë me shume se 3.30-meter e lartë. Duhet të jetë 3 fazore 380V, 50/60Hz.*

#### **4. APARATI VIKAT**

*Aparat Vikat për matje sipas Standartit EN 196-3, ASTM C191, EN 13279-2 ose ekuivalent*

*Te përbehet nga:*

*Unaza plastike sipas EN ose ekuivalent. Pllake mbështetëse qelqi*

*Gjilpëra ballore (initial needle) me diametër 1 -1.2 mm - 6 copë*

*Gjilpëra fundore e pakorrodueshme sipas standartit EN ose ekuivalent*

*Pistoni i konsistencës me diametër 10 mm*

---

*I pajisur me termometri qelqi me diapazon te pakten nga -10 gradë deri në +50gradë C*

## **5. VASKE UJI PER TRAJTIMIN E MOSTRAVE TE CIMENTOS**

*Vaskë për trajtimin e cimentos e bërë nga plastika e forte.*

*Vaska me kapacitet te pakten 550 litra*

*I pajisur me termostat ngrohës per rezervuarin me afishim dixhital te temperatures.*

## **6. TAVOLINË PËR KONSISTENCËN E LLAÇIT**

*Pajisje e cila perdoret per percaktimin e konsistences se llacit dhe gelqeres conform EN459-2 dhe EN1015-2 ose ekuivalent.*

*Pajisja te jete e motorizuar dhe me numerues dixhital. Te kete mundesi per testim duke vendosur numrin e rrotullimeve goditjeve ose duke vendosur kohen totale te punes. Te jete e pajisur me nje hinke mbushese.*

*Tavolina e punes te jete rrethore me nje kallep prej bronxi/inox ose ekuivalent.*

## **7. KOMPLET UNAZASH LE SHATELIE**

*Seti te perfshije te gjitha aksesoret e*

*nevojshme: Set unazash Le Chatelier,*

*me 3 unaza Pjate xhami 50mm, 6 cope*

*Gure peshe 100 g, 3 cope*

*Aparat për matjen e hapjes së unazave, 1 cope*

*Shufër shtypëse me diametër 17mm dhe peshë 70gr, 1*

*cope Vizore Celiku 1cope*

*Vaska e larjes Le Chatelier 220-240V/50-60Hz/1pH*

## **8. PESHORE ANALITIKE DIXHITALE 200GR (0,0000)**

*Kapaciteti i peshimit te pakten 200g*

*Lexueshmeria: 0.1mg*

*Toleranca: ±0.2mg*

*Koha tipike e stabilizimit: jo me shume se 2s*

*Diametri i pllakes se peshimit: 80-110mm*

*Porte USB*

*Mundesi lidhje me printer*

*Te jete konform standardeve EN 61010-1 dhe IEC 60950-1 ose ekuivalent.*

*Shoqeruar me certifikate kalibrimi.*

## **9. FURNELA ME 2 VATRA KUNDER ACIDEVE TE FORTA**

*Furnele me ngrohje me rregullim temperature nga nje termostat me shume pozicione.*

*Pllaka te jete celik inoksi/alumini i veshur me shtrese mbrojtuse ose ekuivalent, per perdorime antiacide te forta, per materiale te tjera korrozive.*

*Me dy vatra te kontrollueshme individualisht.*

*Te operoje nga temperature e ambjentit deri ne te pakten deri 350 °C.*

*Me dy siguresa për të siguruar mbrojtjen elektrike.*

---

## **10. DISTILATOR**

*Pajisje per distilimin e ujit e pajisur me me një pajisje automatike për të mbajtur ujin në nivel me sinjalizues LED per gjendjen e punes konstant dhe për të ndërprerë rrymën në rast të mungesës së ujit, mbinxehjes.*

*Materiali i kondesuesit te jete prej celiku inox.*

*Te prodhoje minimailsht 4 litra ne ore.*

*Distilatori duhet te punoje ne 220-240 V dhe mos kete konsum me shume se 3-4 kW ne ore.*

## **11. PH-METËR DIXHITAL**

*Te jete aparat portabel me klas mbrojtjes IP40 ose me te mire. Diapazoni i matjes: pH: 0 ... 14; mV:  $\pm$  1999*

*Rezolucioni i mV: 0.1mV-1mV*

*Temperatura: 0 ... 100 °C*

*Rezolucioni: 0.01 pH;*

*Kompensim automatik i temperatures*

*Menyrat e kalibrimit: Automatik me 2 ose me shume pika sipas DIN 19266 ose ne menyre automatike ekuivalente.*

*Te shoqerohet me aksesoret: elektroda, sonde temperature, bateri, kase,3 tretesira buferike (acide, bazike dhe neutrale).*

## **12. KALCIMETËR (GASOMETER)**

*Perdoret per percaktimin e CaCO<sub>3</sub> ne gelqere.*

*Te perbehet nga nje ene qelqi në të cilën zhvillohet reaksion midis CaCO<sub>3</sub> qe ndodhet ne produkt dhe HCL.*

*Dimensionet e gazometrit jo me te medha se 400x200x1100mm.*

## **13 BYRETA DIXHITALE**

*Me kapacitet deri ne 50 ml*

*Te kete precision  $\leq$ 0.2 %*

*Ne përputhje me EN ISO 9001 ose ekuivalent*

*Me bateri te rikarikueshme*

*Te perdoret ne temperature deri ne 40°C*

*Te kete mekanizem preciz per mbushje të thjeshtë dhe eliminim të ajrit pa shkaktuar humbje te reagentit.*

---

## **14 KROXHOLA**

*Kroxholat duhet te jene prej porcelani, të paktën 25 ml dhe me kapak.*

*Kroxholat te jene konform standardeve EN 12592, ASTM D2042 ose ekuivalent.*

*Te perballoje temperaturen te pakten 1000°C.*

## **15 MANOMETER**

*Tub qelqi ne forme U per manometer.*

*Te jete konform standarteve EN 196-6, ASTM D1587 ose ekuivalent.*

## **16. MIKROSKOP DIXHITAL**

*Mikroskop digjital.*

*Zmadhimi total: 50x,100x200x,500x.*

*Koke trinokulare me pjerrresi 30°edhe e rrotullueshme 360°.*

*Distanca interpupilare e rregullueshme te pakten ne diapazonin 50 deri ne 75 mm.*

*Pjesa e hundes te pakten 4 pozicione.*

*Te shoqerohet me te pakten me objektivat:*

*5x, 10x, 20x, 50x ,me trajtim kunder mykut te tipit W-PLAN POL.*

*Kondesuesi te jete me hapje numerike N.A. 0.2/0.9 ,me diafragme irisi ,i qenderzueshem ,i fokusueshem edhe i tipit te polarizuar.*

*Mbajtesja e mostres te jete rrethore e rrotullueshme 360° edhe me diameter te pakten*

*140mm. Saktesia e shkalles Vernier te jete 0.1mm. Rezolucioni i imet: 2µm.*

*Shtojca e drites se polarizuar te jete me lente Bertrand e qendersueshme edhe e fokusueshme dhe te perfshihen:*

*- Pllake me vale çerek (1/4 λ pllake)*

*- Pllake e ngjyrosur (1 λ pjate)*

*- Pyke kuarci (pllake Q)*

*Burimi i drites te jete Brightfield , drite te transmetuar edhe drite renese.*

*Burimi i drites renese te jete LED ,me fuqi te pakten 8W edhe jetegjatesia te pakten 50,000 ore. Drita e transmetuar te jete LED ,me fuqi te pakten 3.5W edhe jetegjatesi te pakten 60,000 ore.*

*Te perfshihen filtrat blu edhe jeshil.*

*Kamera e mikroskopit:*

*Rezolucioni te pakten 16 MP.*

*Diapazoni dinamik te pakten 65 DB.*

*Thellesia e ngjyrave te pakten 1,4,8,24 Bit.*

*Koha e ekspozimit me e vogel se 2 sekonda.*

*Frame rate ne rezolucion te plote fps te pakten 2@4600x3400*

*Softuer i pajtueshm me sistemet operative Windows, Mac OS X dhe Linux.*

---

*Kapja e imazheve me mikroskop, regjistrimi i videove live, matja e gjatësive, këndeve, zonave, redaktimi i imazheve.*

*Kablllo USB 2.0 i perfshire.*

*Te perfshihet adaptor i kameres me fokusim 0.5x.*

## **17. SITA PËR PËRCAKTIMIN GRANULOMETRISË**

*Sitë ISO (BS,UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm, me madhesi hapje 0,045 mm 1 copë*

*Sitë ISO (BS,UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,063 mm 1 copë*

*Sitë ISO(UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,075 mm 1 copë*

*Sitë ISO(UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,090 mm 1 copë*

*Sitë ISO(UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,125 mm 1 copë*

*Sitë ISO(UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,250 mm 1 copë*

*Sitë ISO(UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 0,500 mm 1 copë*

*Sitë ISO (BS,UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 1,0mm 1 copë*

*Sitë ISO(BS,UNI,NF,DIN) me diametër 300 mm me madhesi hapje 2 mm 1 copë*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 4 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 6.3 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 8mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 10 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 12.5 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 14 mm pjate 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 16 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 20 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 25 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 31.5 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 37.5 mm 1 cope*

*Sitë me diametër ISO(BS,DIN) 300 mm me madhesi hapje 40mm 1 cope Enë dhe kapak me diametër 300 mm 2 copë*

## **18 FURRË THARJE E PA KORRODUESHME**

*Furre sipas standardeve EN 932-5, EN 1097-5, BS 1924 :1, ASTM C127, C136, D558, D559, D560, D698, D1557, D1559 ose ekuivalente.*

*Furre tharje me kapacitet të paktën 220L*

*Temperatura maksimale: te pakten 200°C.*

*Sistemi dixhital i kontrollit të temperaturës.*

*Pjesa e brendshme te jete material celik inoksi ndersa materiali i jashtem celik i zinkuar.*

*Te furnizohet me te pakten 2 rafte te brendshme.*

*Te kete qarkullim te brendshem te ajrit me ventilator per qarkullim uniforme dhe me saktesi te larte. Te kete termostat sigurie per te shmangur mbinxehjen.*

---

Burimi I energjise: 220-240 V 50/60Hz.

## **19. PAJISJE LOS ANGELES**

*Pajisja sherben per testimin e rezistences se agregateve te trashe ndaj gerryerjes.*

*Pajisja te konform standartit EN1097-2 | ASTM C131 | UNI 8520-19 | EN 12697-17 | EN 12697-43 | NF P18-573 | AASHTO T96 | CNR N° 34 ose ekuivalent.*

*Cilindri i pajisjes te jete prej material çeliku të rëndë me diametër të brendshëm te pakten 700 mm x 500 mm gjatësi të brendshme.*

*Cilindri te jete i kundërbalancuar në mënyrë që hapja e mbushjes të qëndrojë në pozicion pa anuar; Te kete një buton qe lejon pozicionimin e hapjes për veprimet e ngarkim/shkarkimit.*

*Pajisja te jete e pajisur me numerues automatik dixhital i cili mund të paracaktoj numrin e kërkuar të rrotullimeve të kazanit.*

*Rrotulla e testimit vihet ne levizje nga nje motorr elektrik me nje shpejtesi rrotullimi 31-33 rpm Pajisja te furnizohet me setin me 12 sfera abrasive konform EN ose ekuivalent.*

*Pajisja te shoqerohet me nje dollap qe te eliminoj zhurmat e pajisjes gjate punes per te gene konform me direktivat CE. Te kete celes per ndalimin e punes nese hapet dera e dollapit.*

*Te komandohet nga jashte dollapit per te gjitha funksionet e pajisjes*

## **20. KLASIFIKUES I MOSTRAVE ME KAPACITET TË MADH**

*Pajisje qe sherben per klasifikimin e mostrave me kapacitet te madh.*

*Te jete konform standartit EN 933-3, ASTM C136, NF P18-553, UNI 8520, AASHTO T27, T87, BS 812:1, 1377:2, 1924:1, UNE 83120 ose ekuivalent.*

*Kapaciteti mbajtes i pajisjes: të paktën 28 litra.*

*Hapjet te rregullueshme me hapa 12 - 13 mm.*

*Per materiale me madhesi maksimale te pakten 105 mm.*

*I pajisur me 2 ene mbledhese.*

*E ndertuar nga material i forte totalisht i galvanizuar kunder korrodimit.*

## **21. TUNDËS I MOTORIZUAR I SITAVE**

*Tundes elektromekanik per sita sipas standartit EN 932-5, ISO 3310-1 ose ekuivalent.*

*I pershtateshem per sitat me diameter deri ne 315 mm*

*Kapaciteti: te mbaje te pakten 10 sita me diameter 300/315 mm*

*Te jete i kontrolluar me mikroprocesor duke perfshire funksionin e kohëmatësit, intensitetin e vibrimit. Menyren e vibrimit, te vazhdueshem ose me nderprerje dhe te caktoje pausa midis vibracioneve. Te jete me vibrime vertikale, Laterale dhe rrethore. Te kete buton per ndalim ne raste emergjente*

*Te jete i pershtatshem edhe me mostra te lagura.*

---

## **22. PESHORE 60-70KG**

*Peshorja te jete ne perputhje me standartet EN 932-5 ose ekuivalent.*

*Kapaciteti maksimal te jete 60-70 kg.*

*Lexueshmeria: 1 gram*

*Mundesi per te punuar me bateri te rikarikueshme.*

*Pajisja te shoqerohet me certificate kalibrimi*

## **23. PAJISJE PËR PËRCAKTIMIN E MASËS VËLLIMORE TË LIRË DHE I BOSHLLËQEVE**

*Ene metalike prodhuar prej celiku inoks me mbajtese.*

*Në përputhje strikte me standardin: EN 1097-3, ASTM C29-97, BS 812, UNI 8520 :6, ISO 6872, CNR N. 62, 63, 64 ose ekuivalent.*

*Ene me kapacitet 1,5,10 dhe 20 liter te perfshira ne momentin e dorezimit ku 10L dhe 20L te jene me doreza mbajtese.*

## **24. PAJISJE PËR PËRCAKTIMIN E INDEKSIT TË FORMËS**

*Pajijse per matjen e formës dhe per matjen e indeksit te agregatit.*

*Te jete e pershtatshme per matjen e raportit gjatesi-trashesi te grimcave individuale*

*Kalibër sipas EN ose Sitë me forma të përcaktuara*

*Pajisja duhet konform standardin EN 933-4, EN 933-5, EN 933-7, DIN 4226, CNR N.95, NLT 354 ose ekuivalent.*

## **25. PAJISJA E EKVIVALENTIT TË RËRËS**

*Set per testimin e ekuivalentit te reres*

*Sipas EN 933-8, NF XP18-598, UNI 8520-15, UNE 83131 ose ekuivalent.*

*Seti te perfshije 4 cilindra, tapa gome (2 cope), vizore inoksi e graduar, hinke me gryke te gjere, ene matese 200ml, shishe plastike 5 L, Tub ujitës me montim mbyllës dhe sifon, piston per nivelin e reres dhe solucion i perqendruar 1 L.*

*I pajisur me tundes elektrik sipas standarteve EN 933-8, ASTM D2419, NF XP18-598,*

*AASHTO T176, UNI 8520-15, UNE 83131*

## **26. PIKNOMETËR**

*Piknometra 500 dhe 1000 ml*

*Te jene te kompletuar me tapë, tub kapilar dhe gyp.*

## **27. PAJISJE PËR PËRCAKTIMIN E PESHËS SPECIFIKE TË AGREGATEVE TË TRASHA**

---

*Strukture e fortë e krijuar për të vendosur peshoren elektronike sipas standarteve EN 12697, EN 1097-6, EN 12390:7, ASTM C127, C128, AASHTO T84, BS 812:2, 1881:114.*

*Pjesa e poshtme e kornizës te kete një platformë lëvizëse e cila mbart enë me ujë që lejon që mostrat e provës të peshohen si në ajër ashtu edhe në ujë.*

*Kapaciteti maksimal i peshores: jo me pak se 15 kg, me lexueshmeri 0.1g ose me te mire. Peshorja te kryeje peshime me varje.*

## **28. BALON LE CHATELIER**

*Përdoret për të përcaktuar peshën specifike të çimentos hidraulike dhe gëlqeres sipas standarteve EN 196-6, ASTM C188, AASHTO T133 ose ekuivalente. Te kete balon qelqi me kapacitet 250 ml*

*Te kete qafë të shkallëzuar nga 0 deri në 1 ml dhe nga 18 në 24 ml në 0,1 ml.*

*Te jete e pajisur me nje spatul me gjatesi rreth 120mm.*

## **29. PESHORE TEKNIKE 8 KG**

*Peshorja te jete ne perputhje me standartet EN 932-5 ose ekuivalent.*

*Kapaciteti maksimal te pakten 8 kg.*

*Lexueshmeria: 0.1 gram*

*Mundesi per te punuar me bateri te rikarikueshme.*

*Pajisja te shoqerohet me certificate kalibrimi*

## **30 PESHORE TEKNIKE 4 KG**

*Pesha maksimale te jete jo me pak se 4 kg.*

*Lexueshmeria: 0.01g.*

*Riperseritshmeria: 0.01 g.*

*Lineariteti:0.04 g.*

*Koha e pergjigjes me pak se 4 sekonda.*

*Diametri I pjates se peshimit: te pakten 160 mm.*

## **31. KAPË KIMIKE**

*Te jete ne perputhje me standardin EN 14175 -2-3 ose ekuivalent.*

*Te jete me sistem aspirimi te dyfishte*

*Konstrukt metalik*

*Te jete e pershtatshme per shkarkimin e avujve dhe tretesave toksik*

*Dera e perparme te jete transparente, e ngritur nga kunderpesha per nje qasje te lehte ne tavolinen e punes.*



---

*Te jete i pajisur me ndricim.*

*Te kete korniza metalike, 4 priza + celes dhe rubinet uji Me permasa afersisht 1800x800x2500mm*

### **32. VASKË PER TRAJTIMIN E MOSTRAVE TE BETONIT SË BASHKU ME AKSESORË**

*Vaskë për trajtimin e kubikëve të betonit prej çeliku, e galvanizuar ose e zinkuar ne te ngrohte me kapacitet jo më të vogël se 1000lt. Vaska të ketë bazament në formë rrjete për vendosjen e kubikëve dhe tape per te shkarkuar ujin.*

*Vaska duhet të jetë e pajisur me një sistem termostatik ngrohjeje dixhital me rezistence ne zhytje me fuqi te pakten 1500W.*

*Vaska duhet të jetë e pajisur me një pompë qarkulluese e cila punon nën ujë.*

*Vaska duhet të jetë e pajisur me një mbulesë metalike prej çeliku, e galvanizuar ose zinkuar ne te ngrohte.*

*Vaska duhet të jetë e pajisur me një raft të sipërm me rrjetë metalike për kubikët.*

*Vaska duhet te kete permasa te brendshme afersisht 1500x750x750 mm*

### **33. PAJISJE PËR TESTIMIN TOMBINOVE B/A**

*Makineri për testimin e tombinove të betonit b/a me kapacitet jo më të vogël se 1000kN.*

*Pajisja duhet te jete sipas standarteve EN 1916 e krahasueshme me ASTM C301, C497 | BS 5911 | DIN 4035 ose ekuivalent.*

*Pajisja te kete keto te dhena:*

*Levizja e pistonit: te pakten 400 mm*

*Ndenjëse sferike e fiksuar në piston për një ngarkim uniform.*

*Njesia e kontrollit te jete e automatizuar, e kompletuar me grupin e pompimit hidraulik me multi piston, valvul sigurie të presionit maksimal, valvul dekompresimi, valvul kontrolli të fluksit së vajit që jep levizje lineare të ngarkesës.*

*Pajisja e komandimit te kete nje ekran grafik te kompjuterizuar dhe me softuer për marrjen, vizualizimin, përpunimin, printimin dhe ruajtjen e testit të dhëna dhe certifikata. Njesia e kontrollit te jete plotesisht e automatizuar dhe me ekran me prekje me ngjyra.*

*Te kete mundesi te nxjerrjes se arkivave me USB dhe te mundesoj skanimin me barkod te mostrave, etj.*

*Pajisja duhet të jetë e pajisur me programin kompjuterik përkatës për leximin e rezultateve si dhe të ofrohet mundësia e lidhjes së pajisjes në Lan për marrjen e të dhënave dhe*

---

rezultateve në mënyrë direkt në PC. Pajisja duhet që të ketë porta USB për marrjen e të dhënave dhe rezultateve.

Te kete gjithashtu dy tuba fleksibël me presion të lartë, për të lidhur cilindrin me grupin hidraulik.

Mostra me diametri (i jashtëm) maksimal:  $\geq 2600$  mm

Mostra me diametri (i jashtëm) minimal:  $\leq 450$  mm

Mostra me gjatësia maksimale:  $\geq 2500$  mm

Mbajtësit e poshtëm:  $\geq 2500$  mm të gjatë

Trari i sipërm:  $\geq 2500$  mm i gjatë

- Struktura prej çeliku, të lidhur me bulona së bashku me bulona me rezistence të lartë, në mënyrë që të mund të montohet/çmontohet lehtësisht për dërgesë ose për zhvendosje në vend.

- Dy trarë të sipërm, te mund te rregullojne lartesine nepermjet nje motori elektrik me 2 shpejtesi.

- Dy mbajtës të poshtëm që mbështesin kombinon që do të testohet.

Pajisja te kete mbajtës të sheshtë dhe në formë "V" siç kërkohet nga Specifikimi i EN 1916.

Furnizimi me energji i çikrikut: 230/400V 3ph 50/60Hz afersisht 2000W

Pajisja duhet te jete e pajisur me buton per ndalim emergjence

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

### **Instalimi dhe trajnimi**

- Duhet instaluar pajisja në mënyrë që të jetë gati për tu vënë në punë dhe testim.
- OE duhet te siguroje kalibrimin pas montimit të pajisjeve për cdo pajisje që kërkon kalibrim
- Trajnimi te kryhet ne Laboratorin IN-se nga nje person i autorizuar OE .
- Trajnimi duhet të përfshijë vënien në punë, instruksion si të operohet me të,
- interpretimin i te dhënave, informacion për mirëmbajtjen nga ana e përdoruesit dhe për zgjidhjen e problemeve të mundshme.
- Trajnimi duhet të përfshijë analizimin e mostrave reale dhe mostrave të kontrollit
- Periudha e trajnimit 2 javë.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

#### Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia e pritshme	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
				Instituti i Ndertimit	Brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga lidhja e kontratës
1	Presa automatike multifunkionale per betonin	copë	1	Instituti i Ndertimit	Brenda 120 (njëqind e njëzet) ditëve nga lidhja e kontratës
2	Kabinet per laboratorin e cimentos (Dollap per Mostrat e cimentos)	copë	1		
3	Prese per provat ne terheqje te celikut dhe percaktimin e rezistences ne perkulje te celikut	copë	1		
4	Aparat Vikat	copë	1		
5	Vaskat e Ujit	copë	1		
6	Tavoline per konsistencen e llacit	copë	1		
7	Komplet unazash Le Shatelie	set	1		
8	Peshore Analitike Dixhitale 200 gr (0,000)	copë	1		
9	Furnela me 2 vatra	copë	1		
10	Distilator	copë	1		
11	pH-meter	copë	1		
12	Kalcimeter (gasometer)	copë	1		
13	Byreta Dixhitale	copë	3		
14	Kroxhola	copë	30		
15	Manometer	copë	1		
16	Mikroskop digital	copë	1		
17	Sita per percaktimin e granulometrise	set	1		
18	Furre e pa korrodeshme	copë	1		
19	Pajisje Los Angeles	copë	1		
20	Klasifikues i Mostrave me kapacitet te madh	copë	1		
21	Tundes i motorrizuar i Sitave	copë	1		
22	Peshore	copë	1		

23	Pajisje per percaktimin e mases vellimore te lire dhe i boshlliqeve	copë	4		
24	Pajisje per percaktimin e indeksit te formes	copë	1		
25	Pajisja e ekuivalentit te reres	copë	1		
26	Piknometer	copë	2		
27	Pajisje per percaktimin e peshes specifike te agregateve te trasha	copë	1		
28	Balon Le Chatelier	copë	1		
29	Peshore teknike 8 kg	copë	1		
30	Peshore teknike 4 kg	copë	1		
31	Kape Kimike	copë	1		
32	Vaske betoni bashke me aksesore	copë	1		
33	Pajisje per testimin e Tombinove	copë	1		

**Afatet e lëvrimit: 120 ditë nga nënshkrimi i kontratës**

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*
2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen *edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*

#### **2.3Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në

---

vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (*telefon, fax, e-mail, website*) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.
  3. Për të gjithë artikujt objekt prokurimi duhet të paraqiten katalogë / ose skeda teknike ku të jete markuar malli që ofrohet dhe specifikimet teknike përkatëse.
  4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një **deklaratë nga prodhuesi/ distributor i autorizuar**, se afati garancisë së mallrave objekt prokurimi është 2 (dy) vjet nga dorëzimi pranë autoritetit kontraktor, si dhe gjatë këtij afati operatori ekonomik merr përsipër me kostot e tij shërbimin e riparimit për defektet e mundshme nga prodhimi.
  5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër instalimin, vënien në punë, kalibrimin pas instalimit, testimin me analiza të pajisjeve si dhe trajnimin e stafit për dy javë sipas specifikimeve teknike.
  6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:
    - ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
    - ISO 45001:2018 “Mbi sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” (e vlefshme) ose ekuivalent;
  7. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar të pakten një inxhinier informatik/ elektrik/elektronik/mekatronik/fizik/ mekanik/ ndertimi të trajnuar, për pajisjet e mëposhtme / ose ekuivalente me to
    1. Presa automatike multifunksionale për betonin
    2. Prese për provat në tërheqje të çelikut dhe përcaktimin e rezistencës në perkulje të çelikut
    3. Pajisje për testimin e Tombinove.

---

**Per inxhinierin duhet te paraqitet:**

- Diplomë sipas profilit Inxhinier Informatik/Elektrik/Mekatronik/Fizik/Mekanik/Ndertimi;
- CV
- Kontrate individuale pune;
- Certifikatë trajnimi e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ose autoritete / ente të tjera, të autorizuar për lëshimin e certifikatave të formimit profesional / ose ekuivalent, në përputhje me natyrën e pajisjeve më sipër në kriterin nr. 7.

